

PROGRAMI I CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT

MASTER PROFESIONAL NË “REHABILITIM FIZIOTERAPEUTIK NË SPORT”

Programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe synon një formim të avancuar profesional në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit sportiv.

Programi u hap për herë të parë në vitin akademik 2023–2024, me Urdhrin nr. 446, datë 14.08.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Masteri Profesional është konceptuar për të thelluar njohuritë dhe kompetencat profesionale të të diplomuarve të ciklit të parë, me fokus të veçantë në dëmtimet sportive, patologjitë muskuloskeletare, vlerësimin fizioterapeutik, menaxhimin e dhimbjes, parandalimin e dëmtimeve, rehabilitimin ushtrimor dhe optimizimin e performancës sportive.

Programi ndërthur formimin teorik me atë praktik dhe profesional, duke i mundësuar studentit të zhvillojë kompetenca të avancuara për vlerësimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sportistëve, si dhe për bashkëpunimin me profesionistë të tjerë të ekipit multidisiplinar sportiv dhe shëndetësor.

➤ TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

- **Programi i studimit:** Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”
- **Cikli i studimit:** Cikli i dytë
- **Kohëzgjatja:** 1 vit akademik / 2 semestra
- **Gjuha:** Shqip
- **Kredite:** 60 ECTS
- **Forma e studimit:** Me kohë të plotë
- **Emërtimi i diplomës:** “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”
- **Departamenti përgjegjës:** Departamenti i Kineziologjisë

❖ ÇFARË DO TË STUDIOJNË STUDENTËT GJATË PROGRAMIT?

Programi përqendrohet në rehabilitimin fizioterapeutik në sport, duke integruar njohuri mbi lëvizjen, performancën fizike dhe mjekësinë sportive me vlerësimin, parandalimin dhe trajtimin e dëmtimeve sportive. Gjatë dy semestrave, studentët zhvillojnë kompetenca në menaxhimin e dhimbjes, rehabilitimin ushtrimor, rikuperimin funksional dhe rikthimin e sigurt në aktivitet fizik e sportiv. Formimi plotësohet me njohuri në nutricion, aspektet psikologjike dhe menaxheriale të rehabilitimit, si dhe me përvojën praktike në mjedise profesionale sportive dhe shëndetësore.

➤ SEMESTRI I

Në semestrin e parë studentët ndërtojnë bazat e avancuara profesionale në fushën e rehabilitimit sportiv, duke u njohur me aspektet fiziologjike, mjekësore, fizioterapeutike, psikologjike dhe menaxheriale të punës me sportistin.

Programi përfshin:

- **Lënda: LIDERSHIP, MENAXHIM DHE LEGJISLACION NË REHABILITIMIN SPORTIV . Module:** Psikologjia e Aplikuar në Grupe të Ndryshme • Legjislacion dhe Menaxhim në Rehabilitim Sportiv • Lidership dhe Promovim i Rehabilitimit në Aktivitet Fizik
- **Lënda: FIZIOLOGJIA DHE PARIMET E LËVIZJES NË PERFORMANCËN FIZIKE**
Module: Parimet e Avancuara të Lëvizjes së Trupit të Njeriut në Aktivitet Fizik dhe Sport • Fiziologjia e Lodhjes, Rikuperimit, Adaptimit dhe Ndikimi në Performancën Fizike
- **Lënda: MJEKËSIA SPORTIVE NË REHABILITIMIN SPORTIV**
Module: Mjekësia Sportive • Ndhurma e Parë në Sport • Patologjitë Muskuloskeletare
- **Lënda: KONTROLI MJEKËSOR DHE FIZIOTERAPEUTIK NË SPORT**
Module: Kontrolli Mjekësor në Sport • Vlerësimi Fizioterapeutik në Sport
- **Lënda: DHIMBJA, MENAXHIMI DHE REHABILITIMI**
Module: Trajtimi Jomedikamentoz në Dëmtimet Muskuloskeletare

Ky semestër synon të forcojë aftësinë e studentit për të kuptuar në mënyrë të integruar faktorët që ndikojnë në dëmtimin, rikuperimin dhe performancën e sportistit.

➤ SEMESTRI II

Në semestrin e dytë, formimi përqendrohet më drejtpërdrejt në rehabilitimin e dëmtimeve sportive, trajtimin dhe rikuperimin funksional, si dhe në aplikimin e njohurive në praktikën profesionale.

Programi përfshin:

- **Lënda: REHABILITIMI NË DËMTIMET SPORTIVE**
Module: Parandalimi i Dëmtimeve Muskuloskeletare • Trajtimi Rehabilitues dhe Ushtrimor i Dëmtimeve Muskuloskeletare • Rehabilitimi Ushtrimor për Optimizimin e Performancës Sportive
- **Lënda: DHIMBJA, MENAXHIMI DHE REHABILITIMI**
Module: Trajtimi Medikamentoz i Dhimbjes në Dëmtimet Muskuloskeletare
- **Lënda: NUTRICIONI NË SPORT DHE AKTIVITET FIZIK**
Module: Nutricioni në Sport dhe Aktivitet Fizik
- **Lënda: PRAKTIKË PROFESIONALE**

PROVIM PËRFUNDIMTAR

Ky semestër synon të konsolidojë kompetencat profesionale të studentit për ndërhyrjen rehabilituese te sportisti dhe për aplikimin e programeve të individualizuara të rehabilitimit dhe rikthimit në aktivitet fizik e sportiv.

❖ FORMIMI PRAKTIK DHE PROFESIONAL

Praktika profesionale është një komponent i rëndësishëm i programit të studimit dhe synon të lidhë njohuritë e fituara gjatë procesit akademik me situata reale të punës profesionale në fushën e sportit dhe rehabilitimit.

Për realizimin e praktikës profesionale, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit bashkëpunon me klube sportive, struktura sportive, institucione shëndetësore, qendra rehabilitimi dhe struktura të tjera profesionale, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura sipas nevojave dhe organizimit të programit.

Nëpërmjet praktikës, studentët kanë mundësi të frekuentojnë dhe të angazhohen në ambiente reale profesionale, duke u njohur me rastet e dëmtimeve sportive dhe me mënyrën e organizimit të procesit të rehabilitimit.

Praktika synon zhvillimin e aftësive në:

- vlerësimin fizioterapeutik të sportistit;
- identifikimin e problematikave funksionale;
- parandalimin e dëmtimeve sportive;
- rehabilitimin e dëmtimeve muskuloskeletare;
- përdorimin e ushtrimeve rehabilituese;
- monitorimin e rikuperimit;
- rikthimin gradual në aktivitet fizik dhe sportiv;
- bashkëpunimin me ekipin multidisciplinar.

❖ NJOHURITË DHE KOMPETENCAT E TË DIPLOMUARIT

Në përfundim të programit, i diplomuari ka thelluar njohuritë dhe kompetencat profesionale në fushën e fizioterapisë, rehabilitimit dhe mjekësisë sportive.

I diplomuari është i përgatitur për të:

- vlerësuar gjendjen funksionale dhe fizioterapeutike të sportistit;
- identifikuar faktorët e rrezikut dhe problematikat që lidhen me dëmtimet sportive;
- kontribuar në hartimin dhe zbatimin e programeve të rehabilitimit;
- zbatuar programe rehabilituese dhe ushtrimore të përshtatura sipas dëmtimit dhe fazës së rikuperimit;
- përdorur metoda bashkëkohore të rehabilitimit sportiv;
- monitoruar progresin dhe rikuperimin funksional;
- kontribuar në parandalimin e dëmtimeve sportive;
- mbështetur procesin e rikthimit të sportistit në aktivitet fizik dhe sportiv;
- kuptuar dhe zbatuar parimet e rikuperimit dhe optimizimit të performancës fizike;
- bashkëpunuar me mjekë, fizioterapistë, trajnerë dhe profesionistë të tjerë të ekipit multidisciplinar.

❖ MUNDËSITË PËR PUNËSIM DHE ZHVILLIM PROFESIONAL

Përfundimi i Masterit Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” u mundëson të diplomuarve të thellojnë kompetencat profesionale në fushën e rehabilitimit sportiv dhe të angazhohen në struktura ku ofrohen shërbime të fizioterapisë, rehabilitimit dhe kujdesit sportiv, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat profesionale për ushtrimin e profesionit.

Të diplomuarit mund të angazhohen, sipas kompetencave dhe kërkesave të strukturës përkatëse, në:

- klube dhe ekipe sportive;
- qendra të mjekësisë sportive;
- qendra fizioterapie dhe rehabilitimi;
- spitale dhe institucione shëndetësore publike ose private;
- qendra të rehabilitimit sportiv;
- struktura sportive dhe institucione që mbështesin aktivitetin fizik dhe sportiv;
- struktura të tjera ku ofrohen shërbime të fizioterapisë dhe rehabilitimit sportiv.

Formimi i avancuar në këtë program i jep të diplomuarit mundësinë të zhvillojë më tej profilin profesional në drejtim të rehabilitimit të dëmtimeve sportive, parandalimit të dëmtimeve, rikuperimit funksional dhe mbështetjes së performancës sportive.

❖ STAFI AKADEMIK DHE ORGANIZIMI I PROCESIT MËSIMOR

- Programi mbështetet nga një staf akademik i kualifikuar dhe me përvojë, i cili ndërthur përgatitjen akademike me përvojën profesionale dhe klinike. Stafi angazhohet në zhvillimin e procesit mësimor dhe praktik, duke kontribuar në formimin e kompetencave të avancuara të studentëve dhe në përgatitjen e tyre për kërkesat e praktikës profesionale në rehabilitimin sportiv.
- Programi zhvillohet me kohë të plotë.
- Procesi mësimor zhvillohet me prezencë fizike, sipas orarit dhe organizimit të përcaktuar nga Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe zhvillohet nga e hëna deri të premten.

❖ DIPLOMA

Pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve akademike të programit të studimit dhe përfundimit të Provimit Përfundimtar, studenti pajiset me Diplomën “Master Profesional” në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”, së bashku me Suplementin e Diplomës dhe dokumentacionin përkatës akademik, sipas legjislacionit në fuqi.

❖ APLIKIMI DHE REGJISTRIMI

Aplikimi për programin Master Profesional në “**Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport**” kryhet në përputhje me procedurat, afatet dhe kriteret e miratuara nga **Universiteti i Sporteve të Tiranës** dhe institucionet përgjegjëse për arsimin e lartë.

Kandidatët duhet të ndjekin njoftimet zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit për afatet, procedurat dhe dokumentacionin e kërkuar.

KRITERET E PRANIMIT			
Numri minimal i studentëve	12	Numri maksimal i studentëve	50
Titujt e studimit që duhen patur për pranim		▪ Diplomë e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Fizioterapi”, “Shkenca Rehabilitimi” , “Fusha e veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit”, apo diploma të ngjashme me to.	
		• Diplomë të universiteteve të tjera brenda ose jashtë vendit të njëvlefshme me diplomat e sipërpërmendura	
Kriter tjetër		Kriteret e çdo viti	